



Sipas ligjeve federale dhe dekretive të Landit të Saksonisë së Ulët* në lidhje me konceptin e higjienës të institucionit tonë dhe me RREGULLOREN E GODINËS sonë duhet të zbatohen këto rregulla:

Rregulla për vizitat

Për çdo pacient mund të regjistrohet në mënyrë të përhershme vetëm një person shoqëruar, i cili duhet të jetë i shëndetshëm dhe i cili vetëm lejohet të qëndrojë në godinë, nëse i respekton masat e mbrojtjes.

Vizita e një personi tjetër të afërm lejohet çdo ditë nga ora 15 deri në orën 18 ose në raste të veçanta me arsye mjekësore. Më shumë vizitorë nuk mund të lejohen për shkak të rregullave të distancës.

Çdo person përveç pacientes/pacientit duhet të plotësojë pranë hyrjes një formular dokumentimi ngjyrë rozë. Ju lutemi të mbani me vete formularin e dokumentimit gjatë qëndrimit tuaj në godinë dhe dorëzoni atë vetëm gjatë daljes nga godina!

Pas regjistrimit në qendrën e ambulancës dhe të regjistrimit ju lutemi të merrni rrugën e drejtpërdrejtë për në pavijonin e synuar dhe atje lajmërohuni tek sporteli. Atje ndër të tjera merrni një kartë jeshile, që lejon hyrjen për personin e dytë të afërm.

Detyrim për të mbajtur maskë

Të gjithë personat shoqëruar brenda spitalit janë të obliguar të mbajnë maskë. Një raport mjekësor, që liron personin nga obligimi i maskës, NUK pranohet në institucionin tonë.

Maska mund të hiqet, kur personat shoqëruar janë në dhomën e pacientit pranë fëmijës së vet - përderisa respektohet distanca prej 1,5 m ndaj personave të tjerë në dhomë. **Asnjëri nuk duhet të mbajë maskë në gjumë.**

Maska pëlurash lejohen, nëse janë të pastra, nuk janë të lagura dhe nëse mbulojnë totalisht hundën dhe gojën. Nuk lejohen as shami as shalle! Ji kerema xwe re hay ji rêbazên paqijyê yên bingehîn hebin, mîna jihevduurbûnê, her gav şuştina destan û rêbazên kuxîn û pişkînê.

Ju lutemi të vini re rregullat e përgjithshme të higjienës si mbajtjen e distancës, larjen e rregullt të duarve, rregullat e sjelljes për kollitje dhe teshtitje.

* neni 21 spitalet, institucionet e parandalimit të sëmundjeve dhe të rehabilitimit

Në spitale, institucionet e parandalimit të sëmundjeve dhe institucionet e rehabilitimit, pacientet dhe pacientët sipas nenit 3 kanë të drejtë të pranojnë vizita në përputhje me konceptin e higjienës të përpiluar nga drejtoria e institucionit përkatës. Sipas nenit 4, institucioni obligohet të mbledhë të dhënat dhe të dokumentojë të dhënat e kontaktit për çdo vizitore dhe çdo vizitor. (gjendja: 14 korrik 2020)